

GJL nr.944//2011

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. DP	Nr. Prot. 03/4003/11
Dep. DP	Bi Prot. 03/4003/11
Dep. DP	Prot No. 03/4003/11
Nr. i treg. 19.10.2011	Data 19.10.2011
Nr. i treg. 19.10.2011	Data 19.10.2011

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve: Ragip Namani kryetar, Dalip Bega dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me pjesëmarrjen e sek. juridike Ganimete Dumani, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtuar nga e pandehura Gyltene Sylejmani, nga Prishtina, kundër aktvendimit të Gjykatës komunale për kundërvajtje në Prishtinë, Regj.I.nr.29061/2010, të dt. 28.06.2011 e në bazë të neneve 31 al.3, 39 dhe 222 të Ligjit mbi kundërvajtjet, më 18.08.2011, nxjerr:

AKTVENDIM

Ankesa e paraqitur është e **BAZUAR**.

ABROGOHET aktvendimi i Gjykatës komunale për kundërvajtje në Prishtinë, Regj.I.nr.29061/2010, i dt 28.06.2011, dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në plotësim të procedurës dhe rivendosje.

Nga një kopje e këtij aktvendimi u dorëzohet palëve.

Ar sy e t i m

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, me aktvendimin Regj.I.nr.29061/2010, të dt.28.06.2011 të pandehurën Gyltene Sylejmani, nga Prishtina e ka shpallë përgjegjëse:sepse si zyrtare e lartë nuk e ka bërë plotësimin, gjegjësisht përmirësimin e formularit lidhur me deklarimin e pasurisë pranë Agjencionit kundër korrupsionit në afatin e caktuar ligjor, me ç, veprim ka bërë kundërvajtje nga neni 14.3 i sanksionuar me nenin 16 par. 1 pika 1.5 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publikë, për të cilën Kundërvajtje, ia shqiptoi gjobën në shumë prej 150 Euro. Me të njëjtin aktvendim e pandehura është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5 Euro.

Kundër këtij aktvendimi ankesë ka paraqitur e pandehura Gyltene Sylejmani, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimin të gabuar të së drejtës materiale dhe më tutje në arsyetim të ankesës pasi e përshkruan dispozitivin mbi dënim të gjykatës së shkallës së parë ndër të tjera thekson: se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vlerësuar se formulari i plotësuar nuk është dorëzuar me kohë, se ky plotësim është bërë në afatin e paraparë prej 15 ditë nga dita e marrjes së njoftimit më 17.09.2010, se nga shkresat e lëndës rezulton se njoftimi për plotësimin e formularit nuk është dorëzuar në procedurën e paraparë ligjore pasi që bëhet fjalë për dorëzim të shkresave personale se në lëndë nuk ka dëshmi mbi dorëzimin e rregullt të kërkesës për plotësimin e formularit, andaj nga të lartcekurat propozon që ankesa e saj të aprovohet si e bazuar dhe aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të abrogohet dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Kolegji konstatoj se gjykata e shkallës së parë me rastin e zhvillimit të procedurës kundërvajtëse nuk e ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, nuk i ka administruar në tërësi provat e nevojshme, për nxjerrjen e një aktvendimi të bazuar në Ligj dhe fakte. E pandehura gjatë marrjes në pyetje në shkallë të parë nuk e ka pranuar veprën kundërvajtëse, por e ka mohuar përgjegjësinë ku ndër të tjera thekson se njoftimin e Agjencisë kundër Korrupsionit e ka pranuar më datë 17.09.2010 dhe plotësimin e formularit për deklarim të pasurisë e ka dorëzuar në AKK më datë 01.10.2010.

Kolegji konstaton se nga gjykata e shkallës së parë nuk është vërtetuar data e dorëzimit të pandehurës njoftimi i AKK-së i cili njoftim ka pasur edhe afatin e caktuar prej 15 ditë për të përmbushur obligimin nga e pandehura i cili njoftim për të pandehurën përmban edhe masat që do të ndërmerren ndaj saj konform nenit 16 paragrafi 1.5 dhe paragrafi 2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollimin e Pasurisë, dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publik. Në shkresat e lëndës, gjendet fletë kthesa e Agjencisë kundër korrupsionit e ekzekutuar përmes shërbimit postar ku vërehet se për të pandehurën Gyltene Sylejmani, është dërguar diç me shkrim (pa u përcaktuar lloji i dërgesës) dhe se në Gjykatë Supreme është pranuar më datë 17.08.2010, me nënshkrim të marrësit të pa verifikuar, nga ky dorëzim nuk dihet lloji i dërgesës dhe nuk është verifikuar nënshkrimi i marrësit dhe qenësorja po ashtu është e pa njohur se në cilën datë ky njoftim i është dorëzuar të pandehurës dhe nga kush.

Kolegji po ashtu konstaton se dispozitivi i aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë është i pa kjashtë dhe jo i plotë sepse nuk dihet koha e kryerjes së kundërvajtjes pasi që në rastin konkret bëhet fjalë për afat kohor të përcaktuar në ditë e po ashtu aktvendimi nuk përmban në arsyetim prova të bazuara në bazë të cilave është shpallur përgjegjëse e pandehura, andaj nga të lartcekurat aktvendimi si i tillë nuk mund të qëndroj, por duhet të bëhet plotësimi i procedurës.


Në plotësimin e procedurës gjykata e shkallës së parë për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike duhet të veprimi sipas vërejtjeve dhe konstatimeve të gjetura nga Kolegji dhe të ndërmerr këto veprime procedurale, të merr në pyetje në cilësinë e dëshmitarit përfaqësuesin e Agjencionit kundër korrupsionit për të dëshmuar rreth argumenteve që kanë poseduar për parashtrimin e kërkesës ndaj të pandehurës për fillimin e procedurës kundërvajtjeje pasi që e pandehura e ka mohuar veprën dhe meqë njoftimi të pandehurës i është dorëzuar përmes Instutcionit ku punon të merret në pyetje Administratorja e Gjykatës Supreme e cila duhet të dëshmoi se njoftimin në emër të pandehurës e cila në Gjykatë Supreme është pranuar më 17.08.2010, në cilën datë i është dorëzuar të pandehurës pasi që e pandehura ka deklaruar se në kohën e pranimit të njoftimit në Gjykatë ka qenë në pushim vjetor.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave të cekura më lartë sipas nevojë të administroi edhe prova shtesë dhe pas vërtetimit të gjendjes faktike të nxjerrë aktvendim të drejtë të bazuar në prova dhe Ligj.

Nga të lartcekurat konform të nenit 222 të LMK u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar apela.
GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË,
GJLnr.944/2011, dt. 18.08.2011.

SEK. JURIDIKE
Ganimete Dumani



KRYETARI I KOLEGJIT

Ragip Namani